



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

RAPORT VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2023

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit vjetor për konsultimet e kryera publike të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

1. Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural (MBZHR) ka publikuar për konsultim 4 akte nga të cilat 2 janë miratuar dhe 2 janë në proces:

1. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027” të Këshillit të Ministrave, i cili është konsultuar në RENJK, në periudhën 26.8.2022 -26.9.2022, miratuar me VKM nr. 366, datë 16.6.2023.
2. Projektvendimi "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri
3. Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqesore"
4. Projektligji "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" në proces konsultimi.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se gjatë vitit 2023, ka patur 1913 vizitorë nga publiku. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar për vitin 2023, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi, është nevoja për informim më të mirë të publikut dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023, janë miratuar njëzet e dy (22) akte, nga të cilat 21 akte kanë qenë të planifikuara në programin e përgjithshëm analitik të akteve, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023” dhe 1 (një) është miratuar jashtë këtij programi.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Sipas pikës 1, të nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, vetëm 4 akte i janë nënshtruar këtij

procesi, konkretisht projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”, i cili ka rëndësi strategjike dhe është konsultuar në vitin 2022, por është miratuar në vitin 2023. Projektvendimi "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, projektligji "Për deftesat tregtare mbi produktet bujqësore" i cili është konsultuar, por nuk është miratuar dhe projektligji "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", i cili është në proces konsultimi.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Vetëm 1 (një) prej akteve të konsultuara, konkretisht projektligji "Për deftesat tregtare mbi produktet bujqësore" është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, të Rregullores së Këshillit të Ministrave, por nuk është miratuar gjatë vitit 2023.


2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP e vitit 2023 janë parashikuar për miratim 17 projekt-akte (projektligje dhe projektvendime), nga të cilat, janë miratuar 8 akte (VKM). Në aktet e miratuara, janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik: - për 5 projektvendime, në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe 1 projektvendim i cili është nënshtruar konsultimin publik për shkak të rëndësisë që ka. Në PKIE e vitit 2023 janë parashikuar 12 akte. Për periudhën vjetore të vitit 2023 janë miratuar 9 projekt-akte, nga të cilat 2 VKM janë konsultuar dhe 7 aktet e tjera nuk i janë nënshtruar konsultimit publik në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.


Tab 1: Paraqitja e përdorimit të përjashtimeve nga KP

Dokumenti i planifikimit	Projektakte të parashikuara	Projektakte të publikuara për konsultim	Projektakte jo të publikuara për konsultim	% e akteve të publikuara për konsultim
a) PPAP	17	1	5	5,8 %
b) PKIE (për vitin 2023)	12	1	7	8,3 %
c) Dokumente strategjik të sektorit	1	1	0	100%

Grafik 1: Projektakte të parashikuara PPAP vs të konsultuara



Grafik 2: Projektakte të parashikuara PKIE vs të konsultuara



2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Janë konsultuar dy (2) projektvendime me rëndësi strategjike.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata aktuale në krahasim me vitin 2022 mbetet e njëjtë, pasi numri i projektakteve të konsultura me publikun është i ulët, konkretisht vetëm 4 akte të konsultuara. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar kohëzgjatja në tërësi e konsultimit publik për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027” ka qenë relativisht më e madhe dhe për aktet e tjera të konsultuara i është lënë një kohë e mjaftueshme për realizimin e procesit. Përfshirja e aktorëve të interesit është mundësuar nëpërmjet takimeve fizike që në fazën paraprake të draftimit, përpara publikimit në RENJK, për të gjitha aktet e konsultuara.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3(tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. Tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi/teknike,
3. Komunikim nëpërmjet postës elektronike.

Projektaktet e konsultuara i janë nënshtruar këtyre metodave të konsultimit:

1. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”

- Takimet fizike të organizuara nga projekti i BE-së për sigurinë ushqimore me grupet e interesit (24 – 26 nëntor 2021) në zyrën e projektit.
- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (26.8.2022 – 26.9.2022);
- Takimi fizik me grupet e interesit në datën 26.10.2022, në MBZHR;
- Marrja e mendimeve nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera (Nëntor 2022 – Prill 2023).

2. Projektvendimi "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (14.6.2023 – 12.7.2023);
- Marrja e mendimeve nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera (Maj 2023-Korrik 2023).

3. Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore"

- Takimet fizike janë organizuar gjatë periudhës (Prill 2022 – Korrik 2023) mes grupeve të interesit.
- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (3.11.2023 1.12.2023)
- Komunikime nëpërmjet postës elektronike

4. Projektligji “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” në proces konsultimi

- Takimet fizike kanë filluar në Dhjetor 2023 dhe do të jenë në vazhdim, pasi projektakti është akoma në proces konsultimi mes grupeve të interesit.
- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (20.12.2023-22.1.2024)
- Komunikime nëpërmjet postës elektronike

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit/takimeve dhe me email, ndërsa nga konsultimi publik nëpërmjet regjistrisë elektronike për njoftimet dhe konsultimet publike nuk ka patur shumë komente dhe sugjerime.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, janë realizuar konsultime paraprake për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027". Dokumenti i strategjisë është përgatitur nga Projekti i BE-së për Sigurinë Ushqimore, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve. Ky dokument strategjik është konsultuar në takimet e zhvilluara nga projekti i BE-së për sigurinë ushqimore me grupet e interesit dhe palët e interesuara në datat 24-26 nëntor 2021. Konsultimi publik në RENJK u krye për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 26 gusht 2022 deri më datë 26 shtator 2022. Gjithashtu, në datën 26.10.2022 është zhvilluar tryeza e takimit me grupet e interesit dhe institucionet e interesuara nga MBZHR në bashkëpunim me projektin e BE-së "Për sigurinë ushqimore". Si përfundim, kohëzgjatja e konsultimit në tërësi ka qenë nga data 24.11.2021 deri më datë 26.10.2022.

Për projektligjin "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" ka filluar procesi që në prill të vitit 2022 me takimet fizike midis përfaqësuesve dhe ka zgjatur deri në korrik të vitit 2023, ndërsa konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore në respektim të ligjit, ka zgjatur nga data 3 nëntor 2023 deri në 1 dhjetor të vitit 2023.

Projektligji "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" është në proces konsultimi, i cili ka filluar në dhjetor të vitit 2023 me takime fizike të cilat do të vazhdojnë, ndërsa konsultimi publik në RENJK ka filluar procesin në 20 dhjetor të vitit 2023 dhe mbaron në 22 janar 2024.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

1. Kohëzgjatja e konsultimit në tërësi për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027" ka qenë nga data 24.11.2021 deri më datë 26.10.2022.
Konsultimi publik në RENJK ka qenë nga data 26 gusht 2022 deri më datë 26 shtator 2022.
2. Kohëzgjatja e konsultimit në tërësi për projektvendimin "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri ka qenë në RENJK nga data 14 qershor 2023 deri në 12 korrik 2023;
3. Kohëzgjatja e konsultimit në tërësi për projektligjin "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" ka filluar që në prill të vitit 2022 dhe ka zgjatur deri në korrik të vitit 2023, ndërsa në RENJK nga data 3 nëntor 2023 deri në 1 dhjetor të vitit 2023.

4. Kohëzgjatja e konsultimit në tërësi për projektligjin "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" ka filluar në Dhjetor të vitit 2023 me takime fizike të cilat do të vazhdojnë dhe në RENJK ka filluar procesi në 20 dhjetor të vitit 2023 dhe mbaron në 22 janar 2024.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për projekt-aktet e miratuara gjatë periudhës vjetore të vitit 2023, ishte 5 (pesë) muaj.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit përmes RENJK, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët. Megjithatë konsultimi përmes formave të tjera të konsultimit (takime online /postë elektronike) kanë lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces dhe ka rezultuar më i vlefshëm.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Numri i aktorëve jo-qeveritare që morën pjesë në hartimin e projektvendimit:

- Për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027", është 12.
- Për projektvendimin "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri" është 1.
- Për projektligjin "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" është 2.
- Për projektligjin "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", është akoma në proces konsultimi.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për projektvendimin "Përmiratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027" ka qenë:

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së, ESHFF, ISHP, Bashkia Tiranë (AMK) etj;
- Përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Përfaqësues të Univesitetit Bujqësor;

Përfaqësues të Grupeve të interesit, si më poshtë:

- Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
- Industria Ushqimore Shqiptare
- ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- Shoqata e Industrisë së Përpunimit të Qumështit

- Unioni i Prodhuesve Shqiptarë
- Shoqata e Sipërmarrësve Blegtoral të Shqipërisë LEAA
- Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit ADAMA
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për projektvendimin "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri" është "Alb Adriatico 2013" shpk, i cili ka dërguar sugjerimet nëpërmjet RENJK.

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për projektligjin "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" ka qënë:

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së,
- Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF),
- Bankës së Shqipërisë, Ekspertëve të IFC-së,
- përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe
- Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB).

Përfaqësues të grupeve të interesit, si më poshtë:

- Përfaqësues nga shoqatat e fermerëve, të agropërpunuesve, të furnizuesve të lëndëve të para në bujqësi, të grumbulluesve,
- Përfaqësues të bankave, të institucioneve të mikrofinancës dhe të shoqërive të sigurimit.

Për projektligjin "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", kanë filluar takimet në dhjetor të vitit 2023 dhe drafti është publikuar në RENJK, pra konsultimi është akoma në proces. Akti synohet të miratohet në vitin 2024, pra procesi është i papërfunduar.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit për projektaktet e konsultuara për vitin 2023, kanë marrë pjesë 15 palë të interesuara, nga të cilët 4 prej tyre ofruan komente/sugjerime me qëllim përmirësimin e projektakteve.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.

Struktura e kontribuesve në konsultimin publik për projektaktet e konsultuara është:

- Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
- Industria Ushqimore Shqiptare
- ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- Shoqata e Industrisë së Përpunimit të Qumështit
- Unioni i Prodhuesve Shqiptarë
- Shoqata e Sipërmarrësve Blegtoral të Shqipërisë LEAA
- Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit ADAMA

- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.
- Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF),
- Bankës së Shqipërisë,
- Ekspertëve të IFC-së,
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE)
- Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB)
- Përfaqësues nga shoqatat e fermerëve, Të agropërpunuesve, të furnizuesve të lëndëve të para në bujqësi,
- Përfaqësues të bankave, të institucioneve të mikrofinancës dhe të shoqërive të sigurimit.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara për vitin 2023 është në të njëjtat nivele.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027” numri i komenteve të marra ka qenë 8.

Për projektvendimin "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri” numri i komenteve të marra është 1.

Për projektligjin "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" numri i komenteve të marra është 20.

Për projektligjin”Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, është akoma në proces konsultimi.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 29 komente, 21 prej tyre u pranuan plotësisht ndërsa 2 komente u pranuan pjesërisht dhe 6 u refuzuan.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara është në të njëjtat nivele. Përfshirja e aktorëve të interesit në projektaktet e publikuara për konsultim publik të MBZHR-së vazhdon të jetë njëlloj aktive, por kryesisht në kuadër të takimeve fizike ose nëpërmjet postës elektronike. Megjithatë, janë dhënë udhëzime për rritjen e angazhimit dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të interesit si dhe pjesëmarrjen e gjerë të tyre në RENJK, si mjeti kryesor i konsultimit publik.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Projektligji i konsultuar i cili nuk është miratuar gjatë vitit 2023, "Për dëftesat tregtare

mbi produktet bujqësore" është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të rregullores së Këshillit të Ministrave dhe ka pësuar ndryshime gjatë procesit të konsultimit të tij, ndërsa për projektligjin "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", raporti VNR-së është akoma në proces hartimi, pasi projektligji është në proces konsultimi.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Janë hartuar dy raporte individuale konsultimi për projektvendimet e konsultuara, të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike.

2.6.1 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Për të dy projektligjet nuk janë publikuar raportet e konsultimit, pasi nuk janë miratuar dhe mund të kenë ndryshime në vazhdim.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027" vlerësohet me 8 pikë.

Projektvendimin "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara në Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri" vlerësohet me 8 pikë.

Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore" vlerësohet me 8 pikë.

Projektligji "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre", konsultimi është akoma në fillimin e procesit.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces kryesisht në RENJK. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projekt-akteve që hartohen.

Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.

Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i

trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ nga cdo drejtori politike. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projekt-akteve.